



REPUBLIKA E SHQIPËRISË AUTORITETI I KONKURRENCËS

RAPORTI VJETOR 2008

DHE

SYNIMET KRYESORE PËR VITIN 2009

Autoriteti i Konkurrencës
Adresa: Rr. Sami Frashëri, nr. 4, Kati IV, Tiranë
Tel: +355 4 2 234 504
Fax: +355 4 2 234 497
Faqe internetit: caa.gov.al
Email: competition@caa.gov.al

PËRMBAJTJA

I. Fjala e hyrjes	3
II. Aspektet kryesore në zbatim të ligjit dhe Politikës Kombëtare të Konkurrencës.	5
III. Struktura organizative dhe funksionimi i Autoritetit të Konkurrencës	10
III.1. Komisioni i Konkurrencës.	10
III.2. Sekretariati.	10
IV. Monitorimi dhe mbikëqyrja e tregut.	12
IV.1. Hetimi i përgjithshëm në sektorin e energjisë.	12
IV.2. Abuzimi me poziten dominuese.	13
IV.3. Marrëveshjet e ndaluara.	15
IV.4. Kontrolli i përqëndrimeve.	17
V. Aspekte juridike dhe të integrimi Europian.	21
V.1. Vlerësimi legjislativ.	21
V.2. Çështjet gjyqësore të konkurrencës.	22
V.3. Përafrimi i legjislacionit.	24
VI. Kultura dhe advokacia e konkurrencës.	28
VII. Bashkëpunimi me institucionet, entet rregullatore dhe organizmat ndërkombëtare.	29
VIII. Realizimi i buxhetit të Autoritetit të Konkurrencës.	31
VIII.1. Fondi i pagave dhe kontributi i sigurimeve shoqërore.	31
VIII.2. Materiale dhe shërbime të përgjithshme.	32
VIII.3. Mbi realizmin e investimeve.	32
IX. Synimet kryesore të punës për vitin 2009.	33
IX.1. Konsolidimi i kapaciteteve administrative.	33
IX.2. Monitorimi i tregut dhe hetimi i praktikave të mundshme antikonkurrese.	34
IX.3. Forcimi i kulturës dhe i advokacisë për Ligjin dhe Politikën Kombëtare të Konkurrencës.	34
IX.4. Konsolidimi i bashkëpunimit institucional dhe marrëdhënieve ndërkombëtare të Autoritetit të Konkurrencës.	35

I. Fjala e hyrjes

Kryetar i Autoritetit të Konkurrencës
Lindita Milo(Lati), Ph.D.

Roli i autoriteteve të konkurrencës për mbrojtjen e funksionimit të mekanizmave të tregut është bërë gjithnjë e më i pranishëm në ekonominë globale për vetë rëndësinë që ka zbatimi i rregullave të tregut për konsumatorin, biznesin dhe ekonominë në përgjithësi. Për më tepër, kriza globale, ndër të tjera theksoi rolin e autoriteteve mbikëqyrëse dhe rregullatore.

Parë në këtë këndvështrim, Autoriteti i Konkurrencës vëren se ka arritur në një stad më të avancuar të punës së tij, fakt i cili evidentohet nga një perceptim më real i funksionit të Autoritetit nga komuniteti i biznesit, institucionet qendrore dhe vendore, media e shkruar dhe elektronike, si dhe nga publiku i gjërë. Ky fakt shprehet nëpërmjet rritjes së numrit të ankesave të biznesit; mbështetjes institucionale me informacion apo me këshillimin e akteve normative; pasqyrim të shpejtë dhe në kohë reale të shumë prej çështjeve të trajtuara, si dhe nga mbështetja e publikut për hetimet e ndërmarra. Gjithashtu, Progres Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë konstaton se Autoriteti i Konkurrencës është në rrugën e duhur.

Eksperiencia e deritanishme tregoi se eficiency e zbatimit të Ligjit dhe Politikës së Konkurrencës është e lidhur ngushtë me disa faktorë, të cilët kryesisht kanë qënë objektivat e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2008. Për më tepër, mbështetja e dhënë nga Kuvendi i Shqipërisë dhe institucionet qendrore, ka mundësuar realizimin e një rezonance më të qëndrueshme dhe të gjërë të veprimtarisë së institucionit të konkurrencës.

Mbikëqyrja e tregut dhe ndërhyrja ndaj praktikave anti-konkurrese, marrëveshjet e ndaluara apo abuzimet me pozitën dominuese, apo realizimi i kontrollit të përqëndrimeve dhe shit-blerjet e aksioneve përbëjnë thelbin e funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës. Në zbatim të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës efektive në treg, metodologjitë e përdorura janë bazuar në praktikat më të mira dhe rekomandimet e institucioneve homologe ndërkombëtare.

Përmirësimi i instrumentave të hetimit dhe marrja në konsideratë e nivelit të besueshmërisë së të dhënave financiare, është një nga sfidat me të cilat ballafaqohemi. Në këtë kontekst, funksionimi i Autoritetit të Konkurrencës është pjesë e funksionimit të sistemit të informacionit. Prandaj, bashkëpunimi shumë i ngushtë me të gjithë institucionet që prodhojnë apo përpunojnë informacion me natyrë ekonomike, është konsideruar si shumë jetike për zbatimin e ligjit. Në mënyrë të veçantë konsolidimi i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundimi i bazës së të dhënave që ky institucion do të mundësojë, përbën një

faktor shumë të rëndësishëm për rritjen e efijencës së ndërhyrjeve në treg të institucionit të mbikëqyrjes së konkurrencës.

Përsosja e instrumentave ligjorë dhe nënligjorë duke reflektuar eksperiencën në zbatim të ligjit, si dhe duke e përafuar më shumë me të drejtën e konkurrencës dhe praktikën më të mira të Komunitetit Europian ka qënë një aspekt tjetër i konsolidimit të Autoritetit të Konkurrencës. Ky proces nuk është qëllim në vetvete, por pjesë e komunikimit dhe e forcimit të kulturës dhe të advokacisë për konkurrencën me të gjithë aktorët e tregut. Duke marrë në konsideratë këtë fazë të zhvillimit të kuadrit ligjor dhe institucional të mbikëqyrjes së konkurrencës, Komisioni i Konkurrencës ka vendosur të shpallë Ditën Kombëtare të Konkurrencës datën 3 Mars, e cila korrespondon me vendimin e parë të Komisionit të Konkurrencës si institucion publik i pavarur.

Realizimi i procesit të integritimit nuk është konsideruar thjesht një proces i përmbushjes së detyrimeve, por e të qënit pjesë integrale e komunitetit ndërkombëtar me metodologjitë dhe teknikat e përdorura gjatë hetimeve, të cilat ballafaqohen me ato të institucioneve homologe në tryezat e organizuara nga OECD- Rajonale, Rrjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës (ICN), programi TAIEX, etj.

II. Aspektet kryesore në zbatim të Ligjit dhe Politikës Kombëtare të Konkurrencës.

Viti 2008 është një vit me shumë eksperiencë për Autoritetin e Konkurrencës në zbatim të Ligji 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar nga Ligji nr 9499 datë 3.04.2006) dhe të Politikës Kombëtare të Konkurrencës. Gjithashtu gjatë vitit të kaluar, Autoriteti i Konkurrencës ka vepruar në zbatim të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 5.05.2008 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2007” dhe të angazhimeve të ndërmarra.

Veprimtaria e institucionit është përqëndruar në evidentimin dhe ndalimin e marrëveshjeve antikonkurrese, abuzimit me pozitën dominuese dhe kontrollit të përqëndrimeve të realizuara në tregun shqiptar. Gjithashtu, një prioritet tjetër ka qënë rritja e advokacisë dhe e kulturës së konkurrencës, duke përfshirë aktorët dhe faktorët që ndikojnë në zhvillimin dhe në funksionimin e mekanizmave të ekonomisë së tregut. Eksperienca e fituar ka mundësuar përmirësimin e legjislacionit sekondar si dhe realizimin e procesit të vlerësimit dhe të hartimit të draftit të ndryshimeve potenciale në ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Ndër hetimet kryesore të ndërmarra nga Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të Ligjit dhe Politikës së Konkurrencës për vitin 2008 veçojmë:

Hetimi i përgjithshëm në sektorin e energjisë i filluar në fund të vitit 2007 si një nga sektorët që ka një ndikim të drejtpërdrejtë në ekonomi dhe tek konsumatori shqiptar. Qëllimi i hetimit të përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës në tregun e energjisë ishte evidentimi i nivelit të konkurrencës në treg, duke synuar rritjen e efikasitetit të tregut për të krijuar më shumë përfitime dhe mundësi zgjedhjeje për konsumatorët. Hetimi i përgjithshëm përfshiu tre nëntregje: energjinë elektrike, karburantet dhe gazin. Në përfundim të hetimit të përgjithshëm Autoriteti i Konkurrencës, në muajin Mars, filloi procesin e konsultimit të draft raportit të hetimit të përgjithshëm – pjesa energjia elektrike me gjithë palët e interesit.

Komisioni i Konkurrencës bazuar në raportin e paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës mbi “Hetimin e përgjithshëm në sektorin e energjisë, pjesa për energjinë elektrike” si dhe në seancën konsultative me institucionet e interesuara, Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Entin Rregullator të Energjisë Elektrike, KESH-in, Operatorin e Sistemit të Trasmetimit, u shpreh me vendim për disa rekomandime për liberalizimin dhe rritjen e konkurrencës në sektorin e energjisë elektrike

Rekomandimet e Komisionit të Konkurrencës i drejtoreshin Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Entit Rregullator të Energjisë Elektrike, Operatorit të Shpërndarjes dhe Operatorit të Transmetimit, dhe synojnë

ndërmarrjen e hapave të nevojshëm për konsolidimin dhe hapjen reale të tregut të energjisë elektrike, për të siguruar një treg funksional dhe që ofron produktin e mjaftueshëm dhe shërbimin më të mirë në çmimet më të lira të mundshme për konsumatorët.

Në përfundim të hetimit të përgjithshëm në sektorin e energjisë, Komisioni i Konkurrencës, në muajin Mars, mori vendim për hapjen e hetimit të thelluar në tregun e karburanteve ndaj ndërmarrjeve me fuqi të ndjeshme në tregun e shitjes me shumicë të karburanteve. Raporti i hartuar nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës mbi **hetimin e thelluar në tregun e karburanteve** paraqet se këto ndërmarrje kanë zbatuar praktika bashkërenduese duke caktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë çmimet e shitjes. Këto praktika bien në kundërshtim me nenin 4, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës".

Në vijim të procedurave, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 39 të ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës", ka organizuar seancat dëgjimore më datë 26 dhjetor 2008, në të cilat morrën pjesë dy nga gjashtë kompanitë nën hetim. Tre kompani të tjera sipas kërkesës së tyre u paraqitën gjatë muajit janar 2009. Njëra nga kompanitë nën hetim nuk ndërmori asnjë kontakt me Autoritetin e Konkurrencës. Pas përfundimit të seancave dëgjimore dhe konsultimit të pretendimeve të palëve, Komisioni gjatë muajve në vijim do të shprehet me vendim lidhur me këtë hetim.

Autoriteti i Konkurrencës gjatë realizimit të hetimit të thelluar në tregun e karburanteve ka marrë në konsideratë jo vetëm sjelljen e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e shitjes me shumicë të karburanteve, por edhe efektin e akteve normative në funksionimin e këtij tregu. Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të "Raportit të vlerësimit mbi ndikimin e akteve ligjore dhe nënligjore në tregun e karburanteve" (pjesën përkatëse) dhe ankesës së Shoqatës së Shoqërive të Hidrokarbureve konstatoi se: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1110, datë 30.07.2008, "Për cilësinë e lëndës djegëse të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto vendase" sjell kufizime të konkurrencës për shkak të aplikimit të kushteve të pabarabarta të tregtimit ndërmjet ndërmarrjeve që veprojnë në tregun përkatës. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës vendosi t'i rekomandojë Këshillit të Ministrave shfuqizimin e VKM Nr. 1110, datë 30.07.2008, pasi kufizon konkurrencën mes ndërmarrjeve që veprojnë në treg.

Në zbatim të misionit të përcaktuar në ligjin "Për mbrojtjen e konkurrencës", Autoriteti i Konkurrencës në muajin shkurt 2008 ka hapur hetimin paraprak për kufizime të mundshme të konkurrencës në **tregun e importit të grurit dhe të prodhimit të miellit për bukë të zakonshme**. Hetimi filloi bazuar në shqetësimin publik të përcjellë nëpërmjet mediave dhe synonte të evidentonte spekulimet e mundshme në periudha afatshkurtra për shkak të përqendrimit dhe integritetit të disa ndërmarrjeve në tregjet përkatëse në nivelet e ndryshme. Nga hetimi paraprak, Sekretariati arriti në konkluzionin se në këtë treg kishte

elementë të kufizimit të konkurrencës që cënonin ligjin Nr. 9121 date 28.07.2003 “ Për mbrojtjen e konkurrencës “ dhe për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës në muajin tetor 2008, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve importuese të grurit dhe prodhuese të miellit. Procedurat e hetimit të thelluar të ndjekura nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës pritet të përfundojnë brenda muajit shkurt 2009. Në vijim, Komisioni i Konkurrencës do të ftojë në seanca dëgjimore palët e interesuara si dhe do të marrë vendimet përkatëse.

Gjithashtu, gjatë vitit 2008 Autoriteti i Konkurrencës zhvilloi hetime edhe në **tregun e komunikimeve elektronike**, për të parë sjelljen e operatorëve me fuqi të ndjeshme në këtë treg, e në mënyrë të veçantë sjelljen e operatorit të telefonisë fikse Albtelecom pas privatizimit. Pas disa ankesash të operatorëve alternativë të telefonisë fikse, të cilët pretendonin se Albtelekom, AMC dhe Vodafon po abuzonin me pozitën e tyre në treg, Autoriteti i Konkurrencës zhvilloi monitorimin e këtij tregu. Bazuar në këtë raport, në muajin prill, Komisioni i Konkurrencës vendosi t'i rekomandojë Entit Rregullator të Telekomunikacioneve (sot AKEP), plotësimin e kuadrit ligjor të tranzitimit të thirrjeve telefonike ndërkombëtare; miratimin e licencave tip për të gjithë operatorët që veprojnë në tregun e komunikimeve elektronike dhe që ushtrojnë tranzitimin e thirrjeve telefonike ndërkombëtare; si dhe rregullimin dhe licencimin e ofrimit të shërbimeve alternative.

Gjithashtu, Autoriteti i Konkurrencës vendosi hapjen e hetimit paraprak, i cili kishte si objektiv të analizonte sjelljen e OFNT-ve për të verifikuar nëse sjellja e këtyre ndërmarrjeve në treg përbënte abuzim me pozitën dominuese. Në mbyllje të hetimit, në muajin dhjetor 2008, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me vendim për marrjen e disa masave për mbrojtjen e konkurrencës në tregun e tranzitimit dhe interkoneksionit në komunikimet elektronike. Këto masa kanë të bëjnë me moskryerjen e asnjë veprimi të njëanshëm apo pa paralajmërim, jashtë kushteve të marrëveshjeve të interkoneksionit dhe në kundërshtim me Ligjin Nr. 9121, nga operatorët e ndryshëm në tregun e komunikimeve elektronike. Sipas vendimit Albtelecom sh.a, duhet të ndërmerre, brenda afateve kohore të përcaktuara, masa për unifikimet e marrëveshjeve të interkoneksionit me të gjithë operatorët e tjerë si dhe të anulojë pagesat e kryera nga operatorët e tjerë të paparashikuara në marrëveshje të dyanshme. Në të njëjtin vendim Komisioni i Konkurrencës u shpreh për mbylljen e hetimit ndaj operatorëve AMC Sh.a, Vodafone Albania Sh.a. dhe Albtelecom” pasi nga hetimi i realizuar nuk kishte kufizime të konkurrencës të tipit marrëveshje e ndaluar apo abuzim me pozitën dominuese si pasojë e sjelljes së tyre në treg.

Gjatë vitit 2008, Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të Politikës Kombëtare të Konkurrencës dhe të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, ka realizuar monitorimin e **tregut bankar** me qëllim vlerësimin e nivelit të konkurrencës në këtë sektor mjaft të rëndësishëm të ekonomisë. Në përfundim të monitorimit

vendosi hapjen e procedurave të hetimit në tregun primar dhe atë sekondar të bonove të thesarit.

Eksperienca e funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës ka treguar se, eficiency reale e vendimeve të Komisionit varet edhe nga veprimi i institucioneve të tjera publike, si institucioni i drejtësisë apo ai i arkëtimit të gjobave. Sikurse është prezantuar në raportimin vjetor për vitin 2007, vazhdimi i hetimit dhe i vendimmarrjes nga ana e Komisionit në **tregun e sigurimeve** u pezullua me një vendim të Gjykatës së Tiranës, në pranverë të vitit 2007. Ky vendim u ankimua në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila e anuloi vendimin e Gjykatës se Rrethit, duke eliminuar në këtë mënyrë pezullimin e vendosur mbi hetimin për tregun e sigurimeve. Menjëherë pas zbardhjes së vendimit të gjykatës, Autoriteti i Konkurrencës rihapi hetimet në këtë treg. Në bazë të të relacionit të Sekretariatit për hetimin në këtë treg, Komisioni i Konkurrencës vendosi mbylljen e hetimit në tregun e Kartonit Jeshil pasi nuk rezultonte të kishte shkelje të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Në të njëjtën kohë Komisioni vendosi përcaktimin e hapave të hetimit të thelluar në tregun e sigurimit për produktin e sigurimit të detyrueshëm të sigurimit ndaj palëve të treta për mjetet motorrike (TPL).

Në këtë raportim Autoriteti i Konkurrencës paraqet konfirmimin nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë që me rrëzimin e kërkesë padisë së AMC Sh.a konfirmoi vendimin e Komisionit të Konkurrencës mbi abuzimin me pozitën dominuese të AMC Sh.a dhe Vodafone Albania Sh.a, të cilat kishin abuzuar me pozitën dominuese në treg dhe për këtë arsye ishin gjobitur.

Gjatë vitit 2008 Komisioni i Konkurrencës ka marrë 13 vendime që lidhen me **kontrollin përqëndrimeve** nëpërmjet shit/blerjeve të aksioneve të kompanive të ndryshme. Ky vit shënoi jo thjesht rritjen e numrit të rasteve të autorizuara nga ana e Komisionit të Konkurrencës, apo spektrin e sektorëve ku kanë ndodhur këto përqëndrime, por edhe të përmirësimit të procedurave të kontrollit të përqëndrimeve. Tregu financiar, tregu i shitjes me pakicë, sektori i ndërtimit, telefonisë celulare, tregu i përpunimit dhe tregtimit të karburanteve etj., kanë shënuar ndryshime të kontrollit dhe për këtë arsye janë analizuar me kujdes nga ana e Autoritetit të Konkurrencës

Në zbatim të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimitarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2007”, është ndërmarrë nisma e rishikimit të dispozitave të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës (i ndryshuar me ligjin 9499, datë 3.4.2006) me qëllim përafrimin e mëtejshëm të këtyre dispozitave me legjislacionin dhe eksperiencat më të mira të BE-së, si dhe pasqyrimin e eksperiencës së akumuluar gjatë zbatimit të ligjit. Proçesi i vlerësimit të ligjit ekzistues dhe i hartimit të ndryshimeve potenciale është realizuar nga punonjësit e AK-së si dhe me ekspertizën e siguruar nëpërmjet mbështetjes së GTZ-së.

Autoriteti i Konkurrencës i ka kushtuar kujdes plotësimit dhe përsosjes së **legjislacionit sekondar** me qëllim rritjen e forcës zbatuese të ligjit. Kështu, në muajin prill Komisioni i Konkurrencës ka miratuar Udhëzuesin “Për përcaktimin e tregut përkatës” i cili sqaron konceptet bazë për përcaktimin e tregut (kufizimet e konkurrencës; zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës; zëvendësueshmëria nga ana e ofertës; konkurrenca potenciale), mënyrën e përcaktimit të tregut përkatës në praktikë. Gjithashtu janë miratuar me vendime nga Komisioni i Konkurrencës: Rregullorja për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve; Udhëzuesi mbi formën e njoftimit të përqendrimit; Rregullorja e brendshme për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Autoritetin e Konkurrencës, të cilat janë pjesë të legjislacioni sekondar.

Në përputhje me nenin 82 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Autoriteti ka vlerësuar disa akte normative në fuqi dhe po vazhdon me vlerësime të akteve të tjera nënligjore. Më konkretisht, Komisioni i Konkurrencës është shprehur për aktet normative që kanë prekur aspekte të veçanta të tregut të energjisë, telekomunikacionit, farmaceutik, trasmetimet radio-televizive, apo pronësinë industriale, kodin doganor, procedurat tatimore etj.

Ndërgjegjësimi i aktorëve të tregut mbi rolin dhe ndikimin e konkurrencës në rritjen e qëndrueshme dhe mirëqënien konsumatore ka qënë një aspekt tjetër i rendësishëm i aktivitetit të Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2008. Promovimi i kulturës dhe i advokatisë ndaj ligjit për mbrojtjen e konkurrencës u realizua nëpërmjet organizimit të tryezave të rrumbullakëta me komunitetin e biznesit në rrethet kryesore të vendit me mbështetjen e GTZ-së. Në bashkëpunim me Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë në Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan, Korçë, Vlorë dhe Sarandë, është arritur vendosja e një komunikimi dy palësh për të siguruar njohjen dhe zbatimin e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” nga ana e komuniteti të biznesit si dhe realizimin e një perceptimi të drejtpërdrejtë mbi problemet me të cilat ballafaqohet biznesi për një lojë të drejtë midis lojtarëve në treg.

Zbatimi i ligjit dhe i Politikës Kombëtare të Konkurrencës kërkon një aktivitet shumë dimensional të Sekretariatit dhe të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës. Një ndërthurje midis rritjes së kulturës dhe avokacisë së konkurrencës, veprimin konkret ndaj praktikave anti konkurrese, mbrojtjen e vendime të ndërmarra, konsolidimin e legjislacionit sekondar dhe më e rendësishmja konsolidimin e kapaciteteve administrative të institucionit të mbrojtjes së konkurrencës.

III. Struktura organizative dhe funksionimi i Autoritetit të Konkurrencës

Struktura e Autoritetit të Konkurrencës është miratuar me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr 182 datë 12.05.2008. Sikurse paraqitet në organigramën bashkangjitur këtij raporti, struktura organizative përbëhet nga dy pjesë kryesore: Komisioni i Konkurrencës dhe Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës.

Në mënyrë më të detajuar përmbajtja strukturore e Autoritetit të Konkurrencës është paraqitur në vijim

III.1. Komisioni i Konkurrencës.

Komisioni i Konkurrencës, i votuar nga Parlamenti Shqiptar, aktualisht përbëhet prej katër anëtarësh nga pesë që duhet të jenë në përbërjen e tij sipas Ligjit 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar me ligjin 9499, datë 03.04.2006). Veprimtaria shumë dimensionale e këtij komisioni shprehet në strukturën dhe përmbajtjen e 30 vendimeve të ndërmarra gjatë vitit që kaloi, të cilat do të paraqiten në mënyrë më të detajuar në analizën në kapitullin si vijon. Vizioni i Komisionit të Konkurrencës është plotësisht në zbatim të misionit të Autoritetit të Konkurrencës, të përcaktuar në ligjin për mbrojtjen e konkurrencës. Objektivitetit, profesionalizmi dhe transparenca kanë qënë karakteristikat bazë të aktivitetit dhe të vendimmarrjes së tij edhe gjatë vitit 2008.

III.2. Sekretariati.

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, është struktura e ngarkuar me ligj për të kryer monitorimet, studimet dhe mbikëqyrjen e drejtëpërdrejtë të tregut, në zbatim të procedurave hetimore. Sekretariati përbëhet nga tre drejtori dhe sektori i analizës. Sekretariati monitoron kushtet e tregut, kryen hetime administrative dhe harton raporte mbi hetimet, i paraqet dhe i mbron ato para Komisionit të Konkurrencës i cili është organ vendimmarrës. Gjithashtu Sekretariati realizon mbrojtjen e vendimeve të Komisionit të Konkurrencës në sistemin gjyqësor. Punonjësit e Sekretariatit gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

III.2.1. Drejtoria mbikëqyrjes së tregut.

Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut realizon procesin e studimit dhe të mbikëqyrjes së sjelljes së operatorëve në treg, si dhe kushtet e funksionimit dhe të zhvillimit të mekanizmave të tregut në zbatim të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe Politikës Kombëtare të Konkurrencës. Kjo drejtori përbëhet nga tre sektorë të emërtuar sipas tre shtyllave kryesore që prezantohen në ligj, pra sektori i abuzimit me pozitën dominuese, sektori anti-kartel dhe sektori i përqëndrimeve.

III.2.2. Drejtoria juridike dhe procedurave.

Drejtoria Juridike dhe Procedurave realizon argumentimin juridik të produkteve të veprimtarisë së Sekretariatit, drafton aktet rregullatore në zbatim të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe përfaqëson Autoritetin në proceset gjyqësore në mbrojtje të vendimeve të Komisionit ndaj akt-padive nga palët e prekura. Kjo drejtori është e organizuar në dy sektorë: Sektori i përafrimit të legjislacionit dhe procedurave, i cili ka si detyrë kryesore përafrimin e legjislacionit sekondar me atë të Bashkimit Europian si dhe ndjekjen e detyrimeve të Autoritetit të Konkurrencës që rrjedhin nga MSA, të përcaktuara në Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA); si dhe Sektori i çështjeve juridike, i cili ka si detyrë kryesore përgatitjen dhe përfaqësimin në seancat e çështjeve gjyqësore në mbrojtje të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës.

III.2.3. Drejtoria e shërbimeve të brendshme.

Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme është struktura mbështetëse e funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës në realizimin e misionit të tij. Kjo njësi administrative realizon manaxhimin e burimeve njerëzore në përputhje me kërkesat dhe procedurat e ligjit nr 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nënpunësit Civil”, programon zhvillimin e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve duke shfrytëzuar të gjitha burimet e mundshme si OECD, ICN, RCC, ITAP, Universiteti i Tiranës etj. Një drejtim tjetër i punës së kësaj drejtorie është mbulimi i veprimtarisë financiare të Autoritetit dhe mbajtja e përgjegjësisë së plotë për të gjitha procedurat e hartimit dhe të administrimit të fondeve të buxhetit, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e buxhetit të Shtetit Shqiptar.

III.2.4. Sektori i studimit dhe analizës.

Në bazë të vendimit nr.96 datë 30.04.2007 për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Konkurrencës, ky sektor ka si mision vëzhgimin e kushteve dhe kryerjen e analizave ekonomike të strukturave të ndryshme të tregut. Detyra e tij kryesore është identifikimi fillestar i sjelljeve antikonkurrese në treg, në zbatim të ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Nëpërmjet mbledhjes periodike të informacionit, vlerësimit të të dhënave si dhe analizave të kryera nga ky sektor në formën e studimeve mbi tregun, synohet të krijohet një pamje e përgjithshme e tregut nga monitorimi, dhe informacioni i nxjerrë prej sektorit shërben si ndihmesë për sektorët e tjerë të Autoritetit të Konkurrencës në hetimin e mëtejshëm të elementëve anti-konkurrese.

Pavarësisht nga vendosja e punonjësve në sektorë apo drejtori specifike veçoria e punës në Autoritetin e Konkurrencës është puna në grup. Pra, në çdo rast hetimi grupet e punës përmbajnë punonjës që i përkasin sektorëve apo drejtorive të ndryshme.

IV. Monitorimi dhe mbikëqyrja e tregut.

Në pjesën e mëparshme u përshkruan në mënyrë të përmbledhur aspektet kryesore të aktivitetit dhe struktura organizative e Autoritetit të Konkurrencës. Në vijim është paraqitur në mënyrë më të detajuar aktiviteti i realizuar nga secila strukturë organizative e Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe të Politikës Kombëtare të Konkurrencës.

IV.1. Hetimi i përgjithshëm në sektorin e energjisë.

Për të realizuar një nga angazhimet e paraqitur në raportimin e vitit të kaluar, Autoriteti i Konkurrencës ka zhvilluar një hetim të përgjithshëm në **Sektorin e Energjisë**. Qëllimi i hetimit të përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës në tregun e energjisë ishte evidentimi i nivelit të konkurrencës në treg, duke synuar rritjen e efikasitetit të tregut për të krijuar më shumë përfitime dhe mundësi zgjedhjeje për konsumatorët. Raporti i hetimit të përgjithshëm të sektorit të energjisë është ndarë në dy pjesë për shkak të specifikave të funksionimit dhe shkallës së liberalizimit të tyre : energjia elektrike dhe hidrokarburet.

Viti 2008 ishte viti i ndryshimeve të rëndësishme strukturore në tregun e energjisë elektrike, pasi u realizua ndarja në njësi të vecanta administrative sipas funksioneve bazë, atij të prodhimit, transmetimit dhe shitjes së energjisë elektrike. Meqënëse ky është një treg i rregulluar, Autoriteti i Konkurrencës gjatë hetimit ka bashkëpunuar me Entin Rregullator të Energjisë Elektrike dhe Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Në mënyrë të veçantë i është treguar kujdes tërheqjes së opinioneve mbi draftin e raportit të hetimit të përgjithshëm – pjesa e parë, energjia elektrike, duke e dërguar atë për mendim në institucione si METE dhe ERE, ashtu dhe operatorëve të tregut, KESH-Gen, OST, OSSH dhe Shoqatës së Prodhuesve të Pavarur të Energjisë Elektrike. Gjithashtu, drafti i këtij raporti u vendos për konsultim publik në faqen e internetit të Autoritetit të Konkurrencës.

Me qëllim të transparencës në vendimmarrje dhe në zbatim të procedurave, Komisioni i Konkurrencës, më datë 15 Shtator 2008, ftoi në seancë konsultative të gjithë palët e interesit. Kjo seancë u zhvillua me pjesëmarrjen e METE, ERE, KESH-Gen dhe OST. Opinonet e pjesëmarrësve janë marrë parasysh gjatë procesit të vendimmarrjes.

Pas hartimit të raportit dhe seancës konsultative, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me vendimin nr. 90 “Për disa rekomandime për liberalizimin dhe rritjen e konkurrencës në sektorin e energjisë elektrike”. Nëpërmjet tij rekomandohet një liberalizim real të tregut për të krijuar mundësinë e më shumë se një zgjedhjeje të burimit të furnizimit, fillimisht për klientët jo tariforë dhe më pas edhe për klientët dhe konsumatorët tariforë, si dhe nëpërmjet licensimit të ndërmjetësve të tregut; miratimin i tarifave të tregtimit të energjisë elektrike duhet bërë në mënyrë të balancuar dhe pa diskriminime, të cilat duhet të jenë të orientuara drejt kostos mesatare të ponderuar të ofertës së energjisë, duke marrë në konsideratë si

koston mesatare të importit ashtu dhe prodhimit; të monitorojë furnizuesit me shumicë dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes që të marrin të gjitha masat për të përmbushur detyrimet e kontratës së shit-blerjes së energjisë elektrike të lidhur me prodhuesit e vegjël. Gjithashtu, iu rekomandua OST sh.a. dhe OSSH sh.a. që për çdo rast të sigurojë aksesin në rrjet të të gjithë konsumatorëve në përputhje me rregullat e sjelljes së operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg.

Pranë Autoritetit është depozituar një ankesë nga Shoqata e Prodhuesve Privatë të Energjisë Elektrike (SHPPE), sipas së cilës ERE aplikonte dy tarifa të ndryshme për prodhuesit privatë të energjisë. Në tregun e prodhimit, përveç KESH Sh.A ushtrojnë veprimtarinë e tyre private 10 operatorë të licensuar nga ERE për prodhim të energjisë elektrike në burimet hidroenergjetike me fuqi deri në 10 MW. Sasia e energjisë elektrike e prodhuar dhe e shitur nga prodhuesit privatë të energjisë, nëpërmjet KESH-Gen sh.a, është shumë e vogël dhe pothuajse e pandjeshme në krahasim me sasinë e energjisë që prodhon vetë KESH-Gen sh.a.

Në zbatim të funksioneve të saj, ERE ka miratur dy Vendime lidhur me metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et me fuqi deri në 10 MW, përkatësisht: Vendimin Nr 5, datë 26.1.2007 ku çmimi i shitjes së energjisë elektrike është llogaritur mbi bazën e kostos, për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et me fuqi të instaluar deri në 10 MW; dhe Vendimin nr. 24, datë 11.04.2007 ku çmimi i shitjes të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e reja me fuqi të instaluar deri në 10 MW, llogaritet mbi bazën e çmimit të importit.

Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr, 72 datë 19.02.2008 i rekomandoi Entit Rregullator të Energjisë Elektrike shfuqizimin e dy vendimeve dhe unifikimin e metodologjive për përcaktimin e çmimit të shitjes për energjinë e prodhuar nga HEC-et me fuqi deri në 10 MW, si për ata ekzistues edhe për të rinjtë që do jepen me konçension, duke eliminuar vendosjen e operatorëve në kushte të pabarabarta dhe të pafavorshme konkurrence.

IV.2. Abuzimi me poziten dominuese.

Në zbatim të Ligji “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” Autoriteti i Konkurrencës ka si objektiv në aktivitetin e tij parandalimin dhe ndalimin e abuzimit nga një ose disa ndërmarrje me fuqinë e tregut. Ligji në vetvete nuk ndalon pasjen e pozitës dominuese, por abuzimin me këtë pozitë sipas praktikës legjislative europiane.

IV.2.1. Hetimi paraprak në tregun e komunikimeve elektronike.

Sikurse është paraqitur në raportimin e vitit 2007, pranë Autoritetit të Konkurrencës, u depozituan ankesat e disa operatorë alternativë që operonin në zonat rurale dhe urbane. Këto ankesa konsistonin në problemet me nënshkrimin dhe zbatimin e marrëveshjeve të interkoneksionit kryesisht midis Albtelekom dhe Operatorëve Alternativë. Me ndërhyrjen e Autoritetit dhe në bashkëpunim me Entin Rregullator të Telekomunikacioneve (sot Agjensia Kombëtare e

Komunikimeve Elektronike) u arrit të nënshkruhet marrëveshja paraprake e interkoneksionit me operatorin "Nisatel". Kjo marrëveshje do të përbënte modelin e marrëveshjeve të interkoneksionit që do të nënshkruante Albtelekom me të gjithë operatorët alternativë të licensuar për ofrimin e shërbimeve të telefonisë fikse në zonat urbane dhe ato rurale.

Edhe gjatë vitit 2008, operatorët alternativë dhe shoqata e tyre paraqitën pranë Autoritetit të Konkurrencës një sërë ankesash për Operatorët me Fuqi të Ndjeshme në Treg, Albtelekom, Albanian Mobile Communications dhe Vodafone Albania. Gjatë fazës së Monitorimit, Autoriteti i Konkurrencës zhvilloi seanca dëgjimore me të gjitha palët e prekura dhe të interesuara për të evidentuar kufizimet e mundshme të konkurrencës si pasojë e sjelljes së operatorëve në treg apo akteve ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi. Në përfundim të fazës së monitorimit, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me anë të vendimit nr.77 datë 11.04.2008 duke i rekomanduar AKEP të plotësojë kuadrin nënligjor për tranzitimin e thirrjeve ndërkombëtare, si dhe për ofrimin e shërbimeve alternative siç është VOIP.

Gjithashtu, në të njëjtën kohë, Autoriteti i Konkurrencës hapi procedurat e hetimit paraprak për të parë nëse në kuptim të nenit 9 të ligjit nr 9121, operatorët me fuqi të ndjeshme në treg (pozitiv dominuese) abuzonin ose jo me pozitën e tyre dominuese. Në përfundim të hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës vendosi marrjen e masave për mbrojtjen e konkurrencës në tregun e tranzitimit dhe interkoneksionit në komunikimet elektronike. Vendimi kërkonte: Moskryerjen e asnjë veprimi të njëanshëm apo pa paralajmërim, jashtë kushteve të marrëveshjeve të interkonjeksionit dhe në kundërshtim me Ligjin Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", nga operatorët e ndryshëm në tregun e komunikimeve elektronike; nga Albtelecom sh.a, dhe Hermes Communications unifikimin e marrëveshjes së interkoneksionit për një periudhe 1 mujore; nga Albtelecom sha. dhe operatorët alternativë, të cilat kanë depozituar shuma të ndryshme në llogarinë e Albtelecom në formë garancie bankare pa kushte, apo pagesa të tjera të paparashikuara në marrëveshje të dyanshme, të kthejnë çdo pagesë të bërë jashtë këtyre detyrimeve, brenda një periudhe 3 mujore. Për zbatimin e këtij vendimi Albtelecom SHA iu kërkua të njoftojë Komisionin e Konkurrencës për marrjen e masave të mësipërme brenda afateve të përcaktuara.

Me këtë vendim Komisioni vendosi edhe mbylljen e hetimit në tregun e telekomunikacioneve ndaj Albtelecom, AMC sh.a dhe Vodafone Albania sh.a, për sjelljen e tyre në tregun e tranzitimit të telefonatave ndërkombëtare dhe interkoneksionit.

Autoriteti i Konkurrencës do të ketë nën monitorimin e vazhdueshëm tregun e komunikimeve elektronike për çdo sjellje që mund të cenojë konkurrencën e lirë dhe efektive.

IV.2.2. Hetimi paraprak në tregun e bonove të thesarit.

Gjatë vitit 2008, Autoriteti i Konkurrencës realizoi monitorimin në sektorin bankar për të parë nëse kishte apo jo kufizime të konkurrencës si pasojë e sjelljes së një ose disa prej bankave që veprojnë në treg. Në përfundim të monitorimit të kryer në Tregun Primar të Bonove të Thesarit nga Sektori i Studimit dhe Analizës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, vendosi vazhdimin e procedurave të hetimit në Tregun Primar të Bonove të Thesarit”.

Gjithashtu, në tregun sekondar vërehet dukuria e informacionit asimetric. Në vazhdim të procedurave, në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” Komisioni i Konkurrencës vendosi vëzhgimin e kujdesshëm mbi praktikat antikonkurrese që mund të vërtetohen në sjelljen e operatorve në tregun përkatës.

IV.3. Marrëveshjet e ndaluara.

Shtylla e dytë e rëndësishme e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës lidhet me ndalimin e të gjitha marreveshjeve të hapura apo të heshtura, dhe/ose praktikave të koordinuara, të cilat kanë si objekt të tyre fiksimin direkt dhe/ose indirekt të çmimeve, ndarjen e tregjeve dhe/ose të burimeve të furnizimit. Këto lloje marrëveshjesh të ndaluara krijojnë inefiçencë në përdorimin e burimeve ekonomike dhe kalojnë mirëqenien nga konsumatorët tek pjesëmarrësit në marrëveshje.

Autoriteti i Konkurrencës ka bërë monitorime, analiza dhe hetime, me synimin e zbulimit të marrëveshjeve apo të praktikave të koordinuara midis operatorëve në disa tregje, të cilat janë në vijim:

IV.3.1. Hetimi i thelluar në tregun e karburanteve.

Në përfundim të hetimit të përgjithshëm të realizuar në sektorin e energjisë-pjesa e hidrokarbureve, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës vërehen se ka një përqendrim mesatarisht të lartë të tregut të shumicës nga disa operatorë si dhe integrim vertikal të tyre. Sjellja e çmimeve në këtë treg nuk i përgjigjet sjelljes së çmimeve në tregjet furnizuese ndërkombëtare. Tregu mund të karakterizohet nga një konkurrencë e kufizuar e shkaktuar nga firmat me fuqi të ndjeshme në tregun përkatës.

Bazuar në raportin e sipërpërmendur, me Vendimin Nr. 74, datë 11.03.2008, Komisioni i Konkurrencës ka hapur procedurën e hetimit të thelluar në tregun e karburanteve ndaj ndërmarrjeve me fuqi të ndjeshme në treg, i cili synonte të evidentonte ekzistencën e praktikave anti-konkurrese në këtë treg të rëndësishëm për ekonominë dhe konsumatorin shqiptar, Pasi zbatoi procedurat e hetimit të thelluar, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, paraqiti raportin e hetimit të thelluar, i cili shpreh ekzistencën e një sjellje të koordinuar midis

ndërmarrjeve me fuqi të ndjeshme në tregun e shitjes me shumicë të tre produkteve kryesore të karburanteve.

Në zbatim të Nenit 39 të ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës" Komisioni i Konkurrencës ka organizuar seancat dëgjimore duke iu dhënë të drejtën palëve të konsultohen me dosjet përkatëse si dhe të paraqesin pretendimet e tyre me shkrim dhe në mënyrë verbale. Seancat dëgjimore filluan në datën 26 dhjetor dhe vazhduan gjatë muajit janar. Aktualisht Sekretariati po përgatit prapësimet dhe do të realizojë mbrojtjen e argumentave të tij përpara Komisionit të Konkurrencës gjatë muajit Mars 2009.

Gjatë realizimit të hetimit në tregun e karburanteve, për një analizë më objektive të të gjithë faktorëve që veprojnë në funksionimin e tregut, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë në konsideratë jo vetëm sjelljen e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e shitjes me shumicë të karburanteve, por edhe efektin e akteve normative në funksionimin e këtij tregu. Gjatë muajit dhjetor, pranë Autoritetit të Konkurrencës është paraqitur një ankesë nga Shoqata e Shoqërive Hidrokarbure mbi Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1110, datë 30.07.2008. Gjithashtu ky shqetësim është ngritur edhe gjatë seancave dëgjimore me ndërmarrjet e tregëtimit të hidrokarbureve.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të "Raportit të vlerësimit mbi ndikimin e akteve ligjore dhe nënligjore në tregun e karburanteve" dhe ankesës të Shoqatës së Shoqërive Hidrokarbureve konstatoi se Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1110, datë 30.07.2008, "Për cilësinë e lëndës djegëse të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto vendase", në tregun e produktit lëndë djegëse diesel, sjell kufizime të konkurrencës për shkak të aplikimit të kushteve të pabarabarta të tregtimit ndërmjet ndërmarrjeve. Prandaj iu rekomandua Këshillit të Ministrave shfuqizimi i VKM Nr. 1110, datë 30.07.2008, "Për cilësinë e lëndës djegëse të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto vendase" pasi kufizon konkurrencën mes ndërmarrjeve që veprojnë në këtë treg.

IV.3.2. Hetimi i thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit.

Në fillim të muajit shkurt 2008 u njoftua nëpërmjet medias se do të kishte një rritje të çmimit në tregun e bukës masive, i cili do të vazhdonte edhe për periudhën në vijim. Autoriteti i Konkurrencës, duke marrë shkas nga gjetjet e konstatuara gjatë monitorimit të realizuar në tregjet përkatëse të grurit, miellit dhe bukës, bazuar në nenin 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" vendosi hapjen e procedurës së Hetimit Paraprak në Tregun e Importit të Grurit dhe Prodhimit të Miellit.

Bazuar në raportin e paraqitur nga Sekretariati mbi hetimin paraprak, Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr 88 datë 02.10.2008, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve importuese të grurit dhe prodhuese të miellit për periudhën Janar 2005 -31 Gusht 2008. Procedurat e hetimit të thelluar të ndjekura nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës pritet

të përfundojnë brenda muajit Shkurt 2009. Në vijim, Komisioni i Konkurrencës do të organizojë seancat dëgjimore me palët e interesuara si dhe do të marrë vendimet përkatëse.

IV.3.3. Përrjashtimi nga ndalimi i marrëveshjes.

Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të ligjit Nr 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, jep autorizimin për përrjashtim nga ndalimi të marrëveshjeve për shkak të efiçencës ekonomike. Marrëveshja duhet të kontribuojë në përrmirësimin e prodhimit, shpërrndarjes së prodhimit apo promovimit të progresit teknik ose ekonomik, si dhe konsumatorët duhet të marrin një pjesë të barabartë të përrfitimeve të nxjerra. Pra, kufizimi duhet të jetë i domosdoshëm për arritjen e këtyre objektivave. Por, marrëveshja nuk duhet tu japë palëve mundësinë të eliminojnë konkurrencën në lidhje me pjesën thelbësore të produktit në fjalë.

Gjatë viti 2008 pranë Autoriteti i Konkurrencës është depozituar kërkësa për përrjashtimin nga ndalimi i marrëveshjes së lidhur ndërrmjet American Express Limited (AMEX) dhe Alpha Bank A.E. Raporti i paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës konkludoi se zbatimi i kësj marrëveshje do të ndikojë pozitivisht në treg, në shërrbimin ndaj klientëve dhe në zhvillimet e mëtejshme të metodave të pagesës. Tregu i kartave të kreditit dhe debitit në Shqipërri është në fazat e para të zhvillimit dhe hyrja e kartës American Express pritet të nxisë konkurrencën në treg.

Njoftimi për përrjashtim nga ndalimi i marrëveshjes u bë publike për të tërrhequr opinionin e palëve të mundshme të treta të prekura. Bazuar raportin e paraqitur nga Sekretariati dhe në kushtet e mos depozitimi të ndonjë opinionin, Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr 81 datë 10.06.2008 e përrjashtoi për 5(pesë) vjet, nga ndalimi i parashikuar në nenin 4 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Marrëveshjen e Licencës “American Express, Independent Agreement” të lidhur më Dt. 14 Gusht 2007 midis American Express Limited (AMEX) dhe Alpha Bank A.E..

IV.4. Kontrolli i përrqëndrimeve.

Shtylla e tretë e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” është kontrolli i përrqëndrimeve dhe i shit/blerjeve të aksioneve me pasojë ndryshimin e kontrollit. Gjatë vitit 2008, kontrolli i përrqëndrimeve ka zënë një vend të rëndësishëm në fushën e zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator të konkurrencës, duke synuar ndalimin e krijimit apo forcimit të pozitës dominuese në treg si pasojë e përrqëndrimeve të ndodhura.

Rritja e kulturës në zbatim të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës reflektohet në numrin në rritje të rasteve të njoftuara dhe të autorizuara nga Komisioni i Konkurrencës, rreth 16, të cilat ju përrkasin ndryshimeve strukturore në tregun

financiar, të ndarë respektivisht në bankar dhe tregun e sigurimeve, por pa përfshirë edhe tregjet e tjera si: tregun e ndërtimit, të telefonisë, të përpunimit dhe tregtimit të karburanteve, tregun e tregtimit me pakicë të produkteve ushqimore, tregun e tregtimit të makinave etj.

Një karakteristikë tjetër që është evidentuar gjatë procedurave të kontrollit të përqendrimeve është forcimi dhe zgjerimi i kontakteve të para-njoftimit, rritja e transparencës në konsultimet e palëve me Autoritetin, në situatat që synojnë realizimin e një përqendrimi. Në këtë drejtim Autoriteti i Konkurrencës ka punuar për amendimin e akteve nën ligjore ekzistuese, duke përgatitur një paketë të plotë që përfshin rregullore, udhëzues, formularë etj.

Duhet theksuar se procedura e kontrollit të përqendrimeve bazohet në parimin e njoftimit të detyrueshëm të përqendrimeve, para se ato të hyjnë në fuqi. Por kjo nuk e përjashton rastin e hapjes së procedurës së kontrollit të përqendrimit me nismën e vetë Autoritetit të Konkurrencës. Në këtë kontekst, Autoriteti i Konkurrencës ka shqyrtuar 2 raste të nisura me nismën e tij për përqendrim të realizuara në treg.

Gjatë vitit 2008 Autoriteti i Konkurrencës ka shqyrtuar 7 raste njoftime përqendrimesh të cilat nuk përmbushnin të gjitha kriteret sasiore të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” (pragu i xhiros së realizuar nga palët pjesëmarrëse në një transaksion përqendrimi) apo transaksioni i realizuar nuk sillte ndryshime të cilësisë së kontrollit në kuptim të ligjit.

IV.4.1. Autorizimi i përqendrimeve në sektorin financiar.

Me vendimin Nr 70, datë 11.1.2008, Komisioni i Konkurrencës, autorizoi përqendrimin e realizuar, nëpërmjet transaksionit të shitblerjes së 25.4% të kapitalit aksionar dhe të së drejtës së votës në Bankën Credins ShA nga dy shoqëri të huaja, hoolandeze dhe zvicerane (BFSE Holding BV & SIFEM).

Me Vendimin nr 71, datë 29.01.2008, Komisioni i Konkurrencës, autorizoi përqendrimin e realizuar, nëpërmjet blerjes së 45.62% të aksioneve në shoqërinë Sigal Sh.A nga shoqëria austriake Uniqa International sh.a. Ky është përqendrimi i dytë i autorizuar në tregun e sigurimeve, pas marrjes së kontrollit nga një kompani hollandeze në shoqërinë Sigma ShA dhe përbën një zhvillim pozitiv për tregun shqiptar.

IV.4.2. Autorizim i përqendrimeve në sektorin e ndërtimit:

Me Vendimin nr. 75, datë 21.03.2008, Komisioni i Konkurrencës, autorizoi përqendrimin e realizuar, nëpërmjet blerjes së paketës kontrolluese, 51%, të aksioneve në shoqërinë Trema Engineering 2 shpk nga shoqëria austriake Strabag SE. Ky përqendrim që nuk shkakton kufizim për konkurrencën në tregun kombëtar të ndërtimit, si në nivel horizontal ashtu edhe vertikal, për arsye se palët ushtrojnë veprimtari në tregje të veanta gjeografike pritet të rrisë konkurrencën, duke rritur cilësinë mbi bazën e standarteve europiane.

Me Vendimin Nr.78, datë 25.04.2008, Komisioni i Konkurrencës, autorizoi përqëndrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 65% të aksioneve të shoqërisë Alba Cement Italia shpk nga shoqëria greke Antea Cement sha. Ky transaksion do të sjellë një zhvillim të tregut të prodhimit dhe shpërndarjes së çimentos, pasi është parashikuar që shoqëria përfutuese e kontrollit është duke ngritur një fabrikë të re për prodhimin e çimentos, me kapacitete që do të plotësojnë jo vetëm kërkesat brenda vendit por edhe do të eksportojnë.

IV.4.3. Autorizimi i përqëndrimeve në tregun e tregtimit me pakicë

Me Vendimin Nr. 84, datë 14.07.2008, Komisioni i Konkurrencës, autorizoi përqëndrimin e realizuar, nëpërmjet përfutimit të plotë të kontrollit në shoqërinë Euromax nga dy shoqëri të huaja (serbe dhe hollandeze).

Ligji “Për Mbrojtjen e Konkurrencës zbatohet jo vetëm ndaj aktorëve të pranishëm në tregun shqiptar, që me veprimtarinë e tyre në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë prishin ekuilibrat e konkurrencës në treg, por edhe ndaj atyre shoqërive që veprojnë jashtë tregut shqiptar, por që pasojat e tyre ndihen në këtë treg. Në këtë kontekst, me vendimin Nr 85, datë 29.07.2008, Komisioni i Konkurrencës, autorizoi përqëndrimin e realizuar nëpërmjet bashkimit të shoqërive amerikane prodhuese të çokollatave, çamçakizave dhe produkteve të shqerit, Ërigley Company dhe Mars Incorporated.

IV.4.4. Autorizimi i përqëndrimeve në tregun e përpunimit dhe tregtimit të karburanteve:

Me vendimin Nr 91, datë 26.10.2008, Komisioni i Konkurrencës, autorizoi përqëndrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit në masën 85% në shoqërinë më kapital 100 shtetëror, ARMO ShA nga konsorciumi Anika Mercuria Refinery Asspciated Oil sh.a.(AMRA)

Në kuptim të ligjit nr 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, respektivisht nenet 10-12 dhe kreu III i Kontrollit të Përqëndrimeve, Autoriteti i Konkurrencës ka vlerësuar impaktin që mund të ketë ky përqëndrim në treg në kuptim të krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të ndërmarrjeve në treg. Mes shoqërive AMRA Sh.A dhe ARMO Sh.A në mënyrë direkte nuk ka tregje të prekura për shkak se AMRA Sh.A nuk është prezente para përqëndrimit në tregun shqiptar, por në mënyrë indirekte mund të konsiderojmë si tregje të prekura pasi njëri nga aksionerët i cili është edhe administratori i AMRA Sh.A zotëron një shoqëri që veprojnë në tregëtimin të kaburanteve.

Megjithatë, edhe nëse i marrim në konsideratë pjesët e tregut të ARMO Sh.A dhe Taçi Oil International të kontrolluara nga i njëjti person, dhe llogaritet indeksi i përqendrimt HHI, rezulton se shkalla e përqëndrimit të tregut pas përqendrimit rritet por gjithësesi mbetet një treg mesatarisht i përqendruar, pa kaluar në strukturën shumë të përqëndruar të tregut.

Komisioni i Konkurrencës vendosi të autorizojë transaksionin dhe iu kërkoi palëve pjesëmarrëse që në rast të ndryshimit të titullit të pronësisë mbi aksionet e AMRA-s midis aksionerve dhe/ose palëve të treta, t'i drejtohen Autoritetit të Konkurrencës për një vlerësim, përpara realizimit të transaksionit.

IV.4.5. Autorizimi i përqëndrimeve në tregun e telefonisë celulare:

Me vendimin 87, datë 22.09.2008, Komisioni i Konkurrencës, autorizoi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit indirekt në shoqërinë AMC sh.a, nga shoqëria Deutsche Telekom AG në shoqërinë Hellenic Telecommunication Organization SA (OTE). Ky transaksion që realizon përfutimin e kontrollit influencues të operatorit strategjik Deutsche Telekom në OTE, nëpërmjet ndryshimit të politikës së drejtimit, zhvillimit të teknologjisë dhe inovacioneve, ka efekt indirekt në Shqipëri për telefoninë e lëvizshme, ku OTE është prezente në tregun e brendshëm, indirekt, për shërbimet e telefonisë së lëvizshme, nëpërmjet kontrollit të filialit kryesor Cosmote, tek shoqëria AMC ShA.

IV.4.6. Autorizimi i përqëndrimeve në tregun e shitjes së makinave të reja:

Me vendimin 97, datë 18.12.2008, Komisioni i Konkurrencës, autorizoi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit indirekt të shoqërisë Porsche Albania Shpk, filial i shoqërisë Porsche AG, në shoqërinë Ëolkswagen. Porsche Holding Albania shpk ushtron veprimtarinë në importimin dhe shitjen e automjeteve të markës Porsche dhe të markave të tjera si Audi, Seat, Skoda, dhe Ëolkswagen LCV (makina për transport mallrash). Ndërsa shoqëria Ëolkswagen është aktive në tregun e tregtimit të automjeteve, indirekt nëpërmjet filialit të tij në Itali, nga i cili shoqëria shqiptare Classic shpk, importon dhe tregon makina të markave ËV.

V. Aspekte juridike dhe të integrimi European.

Në zbatim të ligjit të konkurrencës, Autoriteti i Konkurrencës vepron ndaj praktikave anti-konkurrese, të cilat janë paraqitur në mënyrë të detajuar në kapitullin e mëparshëm, por realizimi i këtij funksioni nuk mund të jetë i suksesshëm pa marrë në konsideratë aspektet ligjore dhe nënligjore që aplikohen në tregun shqiptar. Gjithashtu, realizimi i vendimeve kërkon një mbrojtje profesionale të tyre në institucionet e drejtësisë, funksion i cili realizohet kryesisht nga juristët dhe me pjesëmarrjen e ekonomistëve. Por, realizimi i nje veprimtarie me efektivitet kërkon ekzistencën dhe zbatimin e legjislacionit sekondar të konkurrencës.

V.1. Vlerësimi legjislativ.

Autoriteti i Konkurrencës, gjatë vitit 2008, ka realizuar vlerësime të akteve normative në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga neni 69 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, si dhe nga Ligji Nr. 9511 “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndërmjetme”. Në këtë kuadër, institucioni i konkurrencës ka dhënë kontributin e tij në vlerësimin e shkallës së shtrembërimit dhe/ose kufizimit të konkurrencës, që rrjedh nga projekt-aktet ligjore dhe nënligjore, për të cilat është kërkuar mendim pranë tij, ose edhe në rastet kur vetë Autoriteti me nismën e tij, ka konstatuar shtrembërime ose pengime të konkurrencës në akte të ndryshme normative.

Autoriteti u është drejtuar institucioneve dhe strukturave përkatëse shtetërore që për çdo akt (i cili potencialisht mund të kishte ndikim në funksionimin e tregut, apo që prek elementet e konkurrencës) të adresohen pranë Autoritetit të Konkurrencës. Në këtë mënyrë, mund të realizohet ndërhyrja *ex-ante* e Autoritetit, e cila do të ndikonte në respektimin më të mirë të rregullave të lojës në treg, duke siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive.

Autoriteti ka vlerësuar shkallën e kufizimit dhe/ose të pengimit të konkurrencës nga projekt-aktet normative si më poshte, dhe konkretisht është shprehur për:

- Projekt-Ligjin “Për Komunikimet Elektronike”, i sjellë për vlerësim nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;
- Projekt-Ligjin “Për Procedurat Tatimore”, drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
- Projekt-Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 205 datë 13. 04. 1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”;
- Projekt-Ligjin “Për Pronësinë Industriale”, Drejtoria e Përgjithshme e Markave dhe Patentave;
- Projekt-Ligjin “Mbi Transmetimet Radio-Televizive në Republikën e Shqipërisë”, drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
- Projekt-Ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, (i ndryshuar);

- Projekt-vendimin “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Komisionit për Vlerësimin e Masave për Importet”, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

Autoriteti, për arsye të interesit të përgjithshëm dhe në zbatim të ligjit, ka bërë vlerësime dhe rekomandime për disa sektorë të rregulluar të ekonomisë, të cilat janë paraqitur në mënyrë më të detajuar në kapitullin e mëparshëm. Vlerësimi legjislativ nuk është qëllim në vetëvete, por një domosdoshmëri për një përdorim më me efektivitet të burimeve kombëtare, pasi përfituesit e drejtëpërdrejtë janë komuniteti i biznesit dhe konsumatori.

V.2. Çështjet gjyqësore të konkurrencës.

Deri më sot nuk ka ende asnjë vendim të Formës së Prerë që të ketë shfuqizuar vendimet e Komisionit të Konkurrencës ose në përgjithësi të Autoritetit të Konkurrencës. Gjatë këtij viti Autoriteti i Konkurrencës ka vazhduar mbrojtjen e Vendimeve të Komisionit të Konkurrencës në të tre shkallët e gjyqësorit dhe konkretisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatën e Apelit Tiranë dhe më pas me rekurse në Gjykatën e Lartë.

Gjatë vitit 2008, në përfundim të Hetimit të Thelluar në Tregun e Prodhimit të Betonit në Qarkun e Tiranës, tre ndërmarrje që ushtronin veprimtari në këtë treg, kundërshtuan Vendimin nr.66, datë 18.12.2007 të Komisionit të Konkurrencës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar pavlefshmërinë e këtij vendimi. Për dy nga çështjet e mësipërme Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesave të ndërmarrjeve. Këto ndërmarrje kanë ankimuar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë vendimet e mësipërme dhe aktualisht jemi në pritje të zhvillimit të seancave gjyqësore. Për çështjen e tretë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pushimin e çështjes.

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është mbrojtur çështja gjyqësore me paditës ndërmarrjen “ProCredit Holding AG” e cila kërkonte shfuqizimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr.63, datë 03.12.2007 “Për vendosje gjobe ndaj shoqërisë ProCredit Holding AG”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë rrëzoi kërkesë-padinë e ndërmarrjes “ProCredit Holding AG” duke lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Konkurrencës. Aktualisht ndërmarrja “ProCredit Holding AG” e ka ankimuar vendimin në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe jemi në pritje të shqyrtimit të kësaj ankese pranë kësaj gjykate.

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është mbrojtur çështja gjyqësore me paditës Shoqëritë e Sigurimit, të cilat kërkonin anulimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr.50, datë 21.03.2007 “Për vendosje gjobe ndaj shoqërive që veprojnë në tregun e sigurimit të detyrueshëm, për produktin Policë Kufitare”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi rrëzimin e padisë së Shoqërive të Sigurimit duke lënë në fuqi Vendimin e Komisionit të Konkurrencës. Aktualisht

Shoqëritë e Sigurimit e kanë ankimuar çështjen në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe jemi në pritje të shqyrtimit të kësaj çështje pranë kësaj gjykate.

Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr.59, datë 09.11.2007 “Për abuzimin me pozitën dominuese në tregun e telefonisë së lëvizshme të shoqërive “Albanian Mobile Communication” sh.a dhe “Vodafone sh.a” është ankimuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga ndërmarrjet “Albanian Mobile Communication” sh.a dhe “Vodafone” sh.a të cilat kërkojnë shfuqizimin e vendimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 19.01.2009 ka rrëzuar kërkesë padinë e AMC-së si të pabazuar në ligj, prova dhe fakte. Ankimi i Vodafon sha është në proces pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ndërmarrja Albanian Mobile Communication sh.a, ka ankimuar Vendimit nr.7, datë 07.05.2008 të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Për hapjen e hetimit paraprak mbi abuzimin ose jo me pozitën dominuese të Altelecom sh.a, Vodafone Albania sh.a, AMC sh.a” duke kërkuar pavlefshmëri dhe të tij pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Aktualisht, kjo çështje është pushuar.

Gjatë vitit 2008, në Gjykatën e Apelit Tiranë u zhvilluan katër çështje gjyqësore, përkatësisht:

Ndërmarrja Çalik Seker Konsorsiyum Yatirim A.S kërkonte shpalljen të pavlefshëm të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr.38, datë 16.05.2006 “Për vendosje gjobe ndaj Çalik Seker Konsorsiyum Yatirim A.S”. Për këtë çështje Gjykata e Apelit Tiranë vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila kishte vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj. Për këtë çështje është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë nga ndërmarrja. Jemi në pritje të zhvillimit të kësaj seance.

Sikurse është raportuar, në vitin 2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë kishte vendosur pezulluar punën e Komisionit të Konkurrencës për vazhdimin e hetimeve të mëtejshme në tregun e sigurimeve. Autoriteti i Konkurrencës ka ankimuar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë këtë vendim. Gjykata e Apelit Tiranë vendosi rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova duke lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Konkurrencës, dhe heqjen e masës së vënies në ekzekutim të përkohshëm të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Ky vendim i hapi rrugën Autoritetit të Konkurrencës të vazhdojë hetimet e mëtejshme në lidhje me këtë treg.

Albania Mobile Communication sh.a ka kërkuar anulimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr.26, datë 02.12.2005 “Për tërheqje të dhënash” dhe Vendimit nr.27, datë 12.12.2005 “Për vendosje gjobe në masën 1% të xhiros vjetore të vitit 2004”. Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim. Autoriteti

i Konkurrencës ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë dhe aktualisht jemi në pritje të zhvillimit të këtij gjykimi.

Ndërmarrja Albania Mobile Communication sh.a kishte kërkuar deklarin të pavlefshëm të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 21, datë 11.10.2005. Gjykata e Apelit Tiranë vendosi pushimin e shqyrtimit të çështjes.

V.3. Përafrimi i legjislacionit.

Rishikimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë në fushën e konkurrencës ka përbërë gjithmonë një përparësi të punës së Autoritetit të Konkurrencës edhe për vitin 2008. Problemet themelore të legjislacionit në fushën e konkurrencës kanë konsistuar:

- *së pari* në amendimin e ligjit ekzistues dhe për një përafrim më të mirë me legjislacionin europian dhe duke synuar një kuadër të plotë ligjor që do të reflektojë punën 5-vjeçare të AK-së;
- *së dyti* në krijimin e një kuadri të plotë mbështetës me akte nënligjore të nevojshme për trajtimin e hollësishëm të të gjithë procedurave dhe mënyrës së funksionimit të institucionit.

Autoriteti i Konkurrencës e ka konsideruar dhe e ka vlerësuar si një element shumë të rëndësishëm përfaqsimin dhe përafrimin e kuadrit ligjor shqiptar në fushën e konkurrencës me kuadrin ligjor Europian. Ky përafrim është i nevojshëm jo vetëm në kuadër të angazhimeve të vendit tonë për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Europian, por edhe për përshtatjen e rregullave me kërkesat dhe nevojat e zhvillimit të tregut. Në hartimin e akteve nënligjore janë marrë në shqyrtim dhe analizuar praktikatat më të mira të vendeve të rajonit dhe më gjerë, si dhe janë implementuar standarde të vendosura nga autoritetet homologe të vendeve europiane dhe ndërkombëtare të konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës ka ushtruar veprimtarinë e tij për realizimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg në zbatim të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, në zbatim të Marrëveshjes Ndërmjetme (MN), të MSA-së, të Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA-së), të Politikës Kombëtare të Konkurrencës, si dhe të gjithë kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e një institucioni publik.

Në zbatim të neneve 37 dhe 38 të MN dhe të neneve 70 dhe 71 të MSA-së, si dhe me synimin e mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, Autoriteti i Konkurrencës ka ndërhyrë dhe ka marrë masa në rastet kur kjo konkurrencë është shtrembëruar, penguar ose kufizuar. Në këtë kuadër, Autoriteti i Konkurrencës ka ndërmarrë nismën e rishikimit të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” me qëllim përafrimin e dispozitave të këtij ligji me legjislacionin e BE-së dhe atë të vendeve anëtare të BE-së, si dhe për të krijuar një bazë të nevojshme që do të mundësojë hartimin e një kuadri të

plotë aktesh nënligjore në zbatim të tij. Amendimi i ligjit organik në fushën e konkurrencës pritet të sjellë një përafrim të plotë të tij me legjislacionin komunitar, si dhe reflektimin e eksperiencës së përfitur gjatë periudhës pothuajse 5-vjeçare duke synuar rritjen e efikasitetit në zbatim të tij. Për këtë arsye, në bashkëpunim edhe me GTZ-në u mundësua ardhja e një eksperti në fushën e konkurrencës, i cili asistoi në vlerësimin legjislativ dhe evidentimin e dispozitave që priten të amendohen duke sjellë dhe propozimet konkrete lidhur me këto ndryshime, të cilat do të paraqiten Kuvendit të Shqipërisë.

Autoriteti i Konkurrencës ka vazhduar ti japë përparësi krijimit të legjislacionit dytësor në fushën e konkurrencës. Komisioni i Konkurrencës ka miratuar një paketë aktesh juridike që rregullojnë dhe qartësojnë procedurat e kontrollit të përqendrimeve. Në këtë paketë përfshihen: Rregullorja e re “Për Zbatimin e Procedurave të Përqendrimit të Ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, si dhe anekset përkatës I dhe II, Formulari i Thjeshtuar i Njoftimit të Përqendrimeve dhe Formulari i Plotë i Njoftimit të Përqendrimeve. Kjo paketë është hartuar dhe miratuar në zbatim të angazhimeve të përcaktuara në Planin Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, duke pasur parasysh legjislacionin Europian për kontrollin e përqendrimeve, si dhe në praktikën më të mirë të vendeve të Bashkimit Europian. Paketa pasqyron përvojën e deritanishme të Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës në këtë fushë. Për hartimin e tyre janë marrë parasysh: Rregullorja e KE Nr. 139/2004, datë 20.01.2004 “Për kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”; Rregullorja e KE Nr. 802/2004, datë 07.04.2004 “Për zbatimin e rregullores së KE, Nr. 139/2004 “Për kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”. Paketa ka karakter shpjegues dhe synon të përmirësojë dhe lehtësojë procedurat që ndjekin ndërmarrjet kur njoftojnë një përqendrim në Autoritetin e Konkurrencës. Kjo paketë aktesh nënligjore sjell risi të tilla si: konsultimin para njoftimit të përqendrimit, duke i dhënë mundësi ndërmarrjeve të konsultohen pranë Autoritetit për rastet e mundshme të përqendrimeve; këshillim të palëve pjesëmarrëse që ta konsiderojnë si paketë njoftimi “Formularin e Thjeshtë të Përqendrimeve”.

Komisioni i Konkurrencës ka miratuar Udhëzuesin “Për përcaktimin e tregut përkatës”, i cili ka për qëllim të shpjegojë nocionin e tregut përkatës, të ndarë në tregun përkatës të produktit dhe tregun përkatës gjeografik, si dhe të shpjegojë metodat, kriteret dhe procedurat për përcaktimin e tregut përkatës. Përcaktimi i tregut është hapi i parë në analizën e rasteve të konkurrencës dhe ka për qëllim të tregojë se si duhet zbatuar koncepti i tregut përkatës të produktit dhe tregut përkatës gjeografik me qëllim të forcimit të ligjit të konkurrencës. Udhëzimi është bazuar në Njoftimin e Komisionit Europian Nr. 97/C372/03 dhe analizon konceptet bazë për përcaktimin e tregut si: kufizimet e konkurrencës; zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës; zëvendësueshmëria nga ana e ofertës; konkurrenca potenciale; procesin e përcaktimit të tregut përkatës në praktikë, mënyrën e llogaritjes së pjesëve të tregut të operatorëve aktive në këtë treg, testet relevante, etj.

Autoriteti i Konkurrencës është në proces të amendimit të Rregullores “Për gjobat dhe lehtësimin prej tyre”, bazuar në Udhëzimin e BE-së “Mbi metodologjinë e vendosjes së gjobave, nenin 23/2/a të Rregullores Nr. 1/2003 (2006/C 210/02), si dhe të Njoftimit të Komisionit “Për imunitetin nga gjobat dhe reduktimin e gjobave në rastet e marrëveshjeve të ndaluara (2006/C 298/11). Qëllimi kryesor i amendimit të kësaj rregulloreje është pikërisht zbatimi i një metodologjie të qartë dhe të përafëruar me standardet europiane gjatë procesit të llogaritjes së gjobës, si dhe përcaktimi i rasteve kur një subjekt përfiton imunitet nga gjobat. Gjithashtu, një rëndësi e veçantë i është kushtuar bashkëpunimit me aktorët e tregut, si një faktor vendimtar në zbulimin e marrëveshjeve të ndaluara apo sjelljeve të koordinuara.

Autoriteti i Konkurrencës është në proces draftimi të projekt-rregullores “Për marrëveshjet me rëndësi të vogël” (*De Minimis*), e cila pritet të përafrojë “Njoftimin e Komisionit Europian mbi marrëveshjet me rëndësi të vogël të cilat nuk e kufizojnë në mënyrë të ndjeshme konkurrencën sipas nenit 81(1) të Traktatit që themelon Komunitetin Europian (*de minimis*)” (C 368, 22/12/2001) . Kjo rregullore është e rëndësishme sepse përcakton rastet kur një marrëveshje nuk konsiderohet si marrëveshje e ndaluar dhe nuk sjell pasoja të shtrembërimit të konkurrencës në treg dhe si pasojë nuk ndalohet nga Ligji. Vetë madhësia e tregut shqiptar dhe mbizotërimi i mikro-ndërmarrjeve nënvizojnë nevojën e realizimit të një rregullore të tillë.

Autoriteti i Konkurrencës ka në proces hartimin e Udhëzuesve “Për marrëveshjet e bashkëpunimit horizontal” dhe “Për marrëveshjet e bashkëpunimit vertikal” në përputhje me Njoftimet e Komisionit Europian “Udhëzues mbi zbatueshmërinë e nenit 81 të traktatit mbi marrëveshjet e bashkëpunimit horizontal (2001/C 3/02) dhe të Udhëzuesit mbi kufizimet vertikale (C 291 , 13/10/2000). Kjo paketë synon të sqarojë mënyrën e vlerësimit të një marrëveshje ose praktikë të bashkërenduar, që është përfunduar ndërmjet ndërmarrjeve, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të njëjtin nivel në treg ose në nivele të ndryshme të të njëjtit treg.

Gjithashtu, është në proces draftimi të udhëzuesve “ Për vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale” dhe të udhëzuesit “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale” në përputhje me udhëzimet e Komisionit Europian “Udhëzues mbi vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale sipas rregullores së KE-së për kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe “Udhëzuesi mbi vlerësimin e përqendrimeve horizontale sipas Rregullores së KE-së për kontrollin e përqendrimeve”. Këto udhëzues priten të qartësojnë se si Autoriteti vlerëson një përqendrim, në rastet kur ndërmarrjet pjesëmarrëse janë aktive në tregje përkatëse të ndryshme.

Autoriteti i Konkurrencës është në proces diskutimi të projekt-rregullores “Për procedurat hetimore që ndjek AK-ja në zbatim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” Kjo rregullore pritet të përafrojë dispozita të

legjislacionit të BE-së të tilla si Rregulloren e BE 1/2003 të datës 16 Dhjetor 2002 “Për implementimin e rregullave të konkurrencës të neneve 81 dhe 82 të Traktatit”, Rregulloren e BE 773/2004 të datës 7 prill 2004 “Për procedurat e vënies në përdorim nga Komisioni në zbatim të neneve 81 dhe 82 të Traktatit të BE”, Njoftim i Komisionit për trajtimin e ankesave nga Komisioni sipas neneve 81 dhe 82 të Traktatit, njoftim i Komisionit për rregullat e aksesit në dokumentet e Komisionit në rastet sipas nenit 81 dhe 82 të Traktatit të BE, nenit 53,54 dhe 57 të Marrëveshjes së EEA-së dhe Rregullores së Këshillit nr 139/2004 etj. Qëllimi kryesor i kësaj rregulloreje është pikërisht saktësimi i procedurave i aspekteve administrative-organizative të proceseve hetimore që duhet të ndjekë AK në zbatimin të Ligjit.

Nga takimi BE-Shqipëri i zhvilluar në Bruksel në Dhjetor 2008 u diskutua dhe u vlerësua puna e kryer nga AK-ja në kuadër të procedurave hetimore të ndjekura nga Autoriteti i Konkurrencës në sektorë të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare, të procesit të përafrimit të legjislacionit në fushën e konkurrencës, të kulturës dhe programeve ndërgjegjësuese të ndjekura nga Autoriteti i Konkurrencës dhe arritjet në këtë fushë, të publikimeve zyrtare të institucionit etj. Nëpërmjet progres raporteve mujore, tremujore dhe vjetore dërguar Ministrisë së Integritimit, Autoriteti i Konkurrencës ka raportuar kryerjen dhe përmbushjen e angazhimeve të ndërmarra në zbatim të MSA-së, respektimin e afateve dhe detyrimeve konkrete. Progres Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë¹ flet për punën e mirë të realizuar nga Autoriteti i Konkurrencës në kuadër jo vetëm të procedurave investigative, por edhe persa i përket advokacisë së konkurrencës, kuadrit ligjor, marrëdhëniet me të tretët etj.

Lidhjet e Autoritetit me Ministrinë e Integritimit kanë qenë të vazhdueshme në funksion të plotësimit të angazhimeve të Autoritetit të Konkurrencës, në kuadër të Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (PKZMSA) dhe përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin për përafrimin e legjislacionit. Të gjitha ndryshimet ligjore të kryera në 2008 kanë pasqyruar në masë të madhe kërkesat e legjislacionit Evropian në fushën e konkurrencës.

¹ Progresi ka vazhduar në fushën anti-monopol...ASHK ka kontribuar në promovimin e kulturës së konkurrencës duke organizuar mbledhje pune, krijuar dokumente të politikës konkurruese dhe duke nënshkruar memorandume mirëkuptimi me autoritete të ndryshme rregulluese. Këto përfshijnë BSh, METE, ERT, ShMK, Drejtorinë e Përgjithshme të Konsumatorëve dhe APP. Kultura e konkurrencës në Shqipëri po zhvillohet ngadalë. Bizneset kanë filluar të paraqesin pakënaqësitë rreth praktikave anti-konkurruese. Kjo tregon për rritjen e kujdesit publik për të mirat e detyrimeve të konkurrencës. ASHK ka imponuar gjobë prej 2 % të xhiros totale për dy shoqëritë e telefonisë celulare për abuzimin me pozicionin e tyre sundues në treg...ASHK gjithashtu ka vendosur gjoba për prodhuesit e bukës dhe përpunuesit e çimentos për shkeljen e rregullave të konkurrencës. ASHK ka lëshuar rekomandime për tregun e telekomunikacionit. Ka vazhduar investigimet në tregun e sigurimeve, vendosi investigim sektorial në tregun e energjisë dhe filloi analizimin e sektorit bankar. Ai gjithashtu vlerësoi disa njoftime bashkimi. Ligji mbi konkurrencën është në masë të gjerë në linjë me acquis. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme për miratimin e legjislacionit implementues në fushën e konkurrencës. (Raporti i Stabilizim Asociimit viti 2008, fq. 30 marre nga www.mie.gov.al)

VI. Kultura dhe advokacia e konkurrencës.

Gjatë aktivitetit të tij në zbatim të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe të Politikës Kombëtare të Konkurrencës, Autoriteti i Konkurrencës e ka parë të domosdoshme forcimin e kulturës dhe të advokacisë si një faktor kyç për eficiencën e ndërhyrjes në treg. Për këtë arsye një nga prioritetet për vitin 2008, i cili është artikuluar qartë edhe në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë datë 5.05.2008 “Për vlerësimin e veprimitarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2007” ka qënë kultura dhe advokacia e konkurrencës.

Puna e Autoritetit të konkurrencës për rritjen e kulturës së konkurrencës gjatë vitin 2008, në procesin e avokacisë së konkurrencës, u përqendrua kryesisht në:

Transparencën e plotë të procedurave të ndjekura nga Autoriteti si dhe organizimi me seriozitetin e duhur të seancave dëgjimore jo vetëm për palët në hetim, por edhe ftesa për gjithë palët e interesuara për proceset e shit/blerjeve dhe të përqendrimeve, brenda kuadrit ligjor. Kjo transparencë është respektuar dhe nëpërmjet publikimit të vendimeve të Komisionit, në kohë reale, si dhe dëgjimi aktorëve të tjerë (institucione shtetërore) përpara dhënies së rekomandimeve. Gjithashtu kjo transparencë është realizuar edhe nëpërmjet pjesëmarrjes publike në media, e cila ka shërbyer dhe për rritjen e kulturës së konkurrencës në Shqipëri.

Gjatë vitit 2008, Autoriteti i Konkurrencës vazhdoi të luajë një rol aktiv për njohjen e grupeve të ndryshme të interesit, biznesit, konsumatorëve, medias, me rolin dhe rëndësinë e funksionimit të ligjit dhe politikës së konkurrencës. Kjo gjë është realizuar nëpërmjet ëorkshopeve, takimeve me grupet e biznesit, takimeve me dhomat kombëtare të tregtisë dhe industrisë.

Rritja e transparencës me publikun ka bërë që gjatë këtij viti të ketë një efekt më të madh të punës dhe ndërhyrjeve të Autoritetit të Konkurrencës në treg. Mjaft media kanë theksuar rëndësinë e Autoritetit të Konkurrencës, si dhe kanë dhënë vlerësimet e tyre në lidhje me punën e zhvilluar prej tij në mbrojtje të konkurruesmerise. Falë tematikës së prekur nga Autoriteti, çështjet e konkurrencës janë parë gjithnjë e më shumë me interes nga mediat e shkruara dhe elektronike, të cilat e konsiderojnë faqen elektronike si burim të informacionit në kohë reale.

Përmirësimin e punës për informimin e biznesit dhe të gjithë opinionit publik për njohjen e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e konkurrencës, duke rritur bashkëpunimin me subjektet që ushtrojnë veprimtari në treg dhe duke konsideruar median si një faktor të rëndësishëm në përcjelljen në publik të politikave kombëtare të konkurrencës.

VII. Bashkëpunimi me institucionet, entet rregullatore dhe organizmat ndërkombëtare.

Autoriteti i Konkurrencës, duke e konsideruar të rëndësishëm bashkëpunim me institucionet qendrore, vendore dhe përfaqësues të biznesit, ka nënshkruar disa memorandume mirëkuptimi. Janë nënshkruar memorandume mirëkuptimi midis: Autoritetit të Konkurrencës dhe Zyrën Shqiptare për të Drejtën e Autorit, Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Tiranës, etj. Nëpërmjet këtyre memorandumeve synohet të rritet bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacioneve gjatë procedurave hetimore që ndërmerr Autoriteti i Konkurrencës.

Në funksion të ndërtimit të një bashkëbisedimi më të drejtëpërdrejtë me komunitetin e biznesit dhe aktorë të tjerë të tregut janë organizuar disa tryeza të rrumbullakta të mbajtura në Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Sarandë, dhe Korçë me temë "Për një treg më konkurrues". Këto tryeza janë organizuar në bashkëpunim me dhomat e tregëtisë dhe kanë marrë pjesë përfaqësues të dhomave të tregtisë dhe industrisë, përfaqësues të biznesit, të studiove ligjore, të përfaqësuesve të administratës vendore etj., nëpërmjet të cilave synohej ndërgjegjësimi i biznesit dhe publikut për dispozitat ligjore mbi konkurrencën, mbi veprimtarinë e institucionit, mbi Politikën Kombëtare të Konkurrencës, mbi programin e lehtësimit nga gjobat që ofron Autoriteti i Konkurrencës për ndërmarrjet që bashkëpunojnë me Autoritetin në rastet e marrëveshjeve të ndaluara. Gjithashtu këto bashkëbisedime ndihmuan për një perceptim më të drejtëpërdrejtë të probleme me të cilat ballafaqohet biznesi.

Autoriteti i Konkurrencës ka qenë aktiv në marrëdhëniet ndërkombëtare nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit me Autoritete homologe të Konkurrencës, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në veprimtaritë e ndryshme ndërkombëtare të organizuara.

Vetë dinamika e tregut dhe problemet që mund të shfaqen në këtë treg, si dhe ato ekzistuese nxisin nevojën e bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare në kuadrin e mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Në këtë frymë, Autoriteti i Konkurrencës ka intensifikuar kontaktet dhe shkëmbimin e përvojës me homologët dhe ka siguruar një pjesëmarrje gjithnjë e më të shpeshtë në veprimtaritë e organizuara prej organizmave ndërkombëtarë. Bashkëpunimi ndërkombëtar bëhet edhe më i rëndësishëm për shkak të nevojës së futjes në zbatim të Direktivave të BE-së dhe zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Duke qenë se Autoriteti është edhe anëtar i ICN, (Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës), është mundësuar pjesëmarrja e Autoritetit të Konkurrencës në veprimtaritë e ndryshme të organizuara nga ICN-ja, në lidhje me çështjet e konkurrencës dhe synimi i funksionimit të këtij bashkëpunimi dhe anëtarësimi lidhet pikërisht me shkëmbimin e përvojave me autoritetet e konkurrencës së

vendeve të ndryshme, si dhe me hartimin dhe njësimin e standardeve dhe rregullave të konkurrencës.

Marrëdhëniet me donatorët vazhdojnë të jenë një faktor mbështetës, tepër i rëndësishëm në realizimin e projekteve strategjike të Autoritetit të Konkurrencës , me qëllim ngritjen institucionale, si dhe për nxitjen dhe zhvillimin e institucionit. Vlen të përmendet bashkëpunimi me GTZ-në një nga partnerët e Autoritetit të Konkurrencës, i cili ka mundësuar organizimin e një sërë ëorkshopesh në qarqe të ndryshme të Shqipërisë, ka mundësuar ardhjen e ekspertëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë, të cilët ndihmojnë stafin e AK-së në procese të ndryshme hetimore ose në proceset legjislative, ka mundësuar financimin e disa publikimeve të Autoritetit etj.

Gjithashtu, një burim tjetër i marrë në konsideratë nga Autoriteti i Konkurrencës ka qënë programi i TAIEX-i. Nëpërmjet aplikimeve Autoriteti i Konkurrencës ka përfituar vizita ekspertesh dhe organizimin e ëorkshopeve me eksperte ndërkombetare. Anëtarë të stafit të Autoritetit të Konkurrencës kanë marrë pjesë në kurse intensive trajnimi, seminare, ëorkshop-e dhe konferenca rajonale dhe ndërkombëtare të organizuara nga OCDE-ja, ICN-ja, autoritetet homologe të konkurrencës në Europë, Shtetet e Bashkuara, dhe më gjerë, projekti GTZ, ITAP, UNCTAD, etj, në të cilat është shkëmbyer përvoja, janë diskutuar rastet konkrete të shqyrtuara nga institucioni jonë në mbrojtje të konkurencës së lirë dhe efektive në treg.

VIII. Realizimi i buxhetit të Autoritetit të Konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2008 ka zbatuar me korrektësi kërkesat e Ligjit nr, 9645, datë 27.11.2006 “ Për buxhetin e shtetit të vitit 2007” në lidhje me përdorimin e fondeve buxhetore.

Administrimi i vlerave materiale e monetare është konsideruar një fushë e rëndësishme e punës tonë duke zbatuar me korrektësi të gjitha aktet ligjore e nënligjore dhe normativat në përdorimin e fondeve buxhetore. Puna në sektorin e financës është e lidhur me transaksionet financiare, si dhe ndjekjen dhe mirëadministrimin e shpenzimeve buxhetore dhe investimeve të cilat janë të lidhura me veprimtarinë e institucionit. Gjithashtu, ajo ka siguruar të dhëna për veprimtarinë financiare, si dhe ka përcaktuar e ndjekur realizimin e shpenzimeve, të ardhurat, rritjen e aktiveve të institucionit. Në tërsinë e vet ky sektor ka ndikuar në përmirësimin dhe arritjen e objektivave dhe detyrave që ka institucioni i konkurrencës.

Një përmbledhje e treguesve buxhetorë të vitit 2008 paraqiten si me poshtë:

000 leke				
Nr. Emërtimi	Plan	Fakt	Diferenca	Realizimi(%)
1. Shpenzime personeli				
	42,045	40.100	1.945	95,4.
2. Materiale dhe shërbime të përgjithëshme				
	13.518	13.082	436	96,7
3. Investime				
	4.000	3,827	173	95,6
TOTALI	59 563	57 009	2 554	95,7

Të dhënat financiare tregojnë një realizim prej 95,7% .

VIII.1. Fondi i pagave dhe kontributi i sigurimeve shoqërore.

Fondi i pagave i planifikuar për Autoritetin e Konkurrencës ishte 42.045 mijë lekë nga të cilat janë realizuar 40,099 mijë lekë ose 95,4% me një diferencë më pak nga programimi prej 1,945 mijë lekë. Ky mosrealizim ka ardhur kryesisht nga mungesa e një komisioneri dhe dy vendeve vakant në 6 mujorin e dytë të vitit. Gjatë realizimit të këtij elementi buxhetor janë zbatuar kërkesat e të VKM nr 901, datë 19.12.2007 te ndryshuar dhe të Ligjit nr 9584 datë 17.07.2006 “ Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe te institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj. Gjithashtu, janë ndalur dhe derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore, shendetësore dhe tatimi i pagës për çdo punonjës sipas udhëzimeve përkatëse.

VIII.2. Materiale dhe shërbime të përgjithshme.

Për materiale dhe shërbime të përgjithshme ishin parashikuar 13.518 mijë lekë, të cilat janë realizuar në vlerën 13.082 mijë lekë ose 96.7 % , me një diferencë me pak nga plani prej 436 mijë lekë. Ky mosrealizim ka ardhur kryesisht nga fondet e pa përdorura për udhëtim e dieta, shërbime telefonike etj

Gjatë vitit 2008 i është kushtuar rëndësi zbatimit të ligjit për dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare. Në blerjet me vlera të vogla janë zbatuar me korrektësi kërkesat e ligjit nr 9643, date 20.11.2006 “ Për prokurimin publik” dhe për blerjet e tjera mbi kufirin 400 mijë lekë janë zhvilluar proceset e tenderimeve konform kërkesave të dispozitave ligjore.

VIII.3. Mbi realizimin e investimeve.

Për investimet nga 4.000 mijë lekë të planifikuara në fillimin e vitit janë realizuar 3.827 mijë lekë ose 95.6. %. Fondet e përdorura për investime janë kryesisht për pajisje dhe orendi zyrash, kompjutera e pajisje kompjuterike, si dhe blerje e nje autoveture te re, investime të nevojshme për krijimin e kushteve të punës së punonjësve të administratës së Autoritetit të Konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës ka realizuar arkëtime nga realizimi i procedurave të kontrollit të përqëndrimeve dhe i shit-blerjeve të aksioneve të ndërmarrjeve, të cilat janë derdhur në buxhet për shumë 4.75 milion lekë.

IX. Synimet kryesore të punës për vitin 2009.

Për vitin 2009 Autoriteti i Konkurrencës duke qënë në koherencë me autoritet homologe të konkurrencës, si dhe duke marrë në konsideratë efektet e një ekonomie të globalizuar, ka vendosur dy drejtime kryesore: rritja e profesionalizmit dhe e ekspertizës së stafit teknik të Autoritetit dhe rritja e ndërgjegjësimit të publikut mbi përfitimet që sjell konkurrenca në treg. Këto dy drejtime ndikojnë ndjeshëm në konsolidimin e mëtejshëm të Autoritetit Shqipëtar të Konkurrencës.

IX.1. Konsolidimi i kapaciteteve administrative.

Rritja e numrit të rasteve dhe ndryshueshmëria e madhe nga një hetim në një sektor në tjetrin kërkon kualifikime të konsiderueshme të stafit të ekonomistëve dhe juristëve që janë të angazhuar me procedurat hetimore. Prandaj, një ndër sfidat kryesore të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2009 është forcimi i kapaciteteve administrative të ngarkuara me zbatimin e ligjit dhe Politikës Kombëtare të Konkurrencës. Për të mundur vetë-kualifikimin e vazhdueshëm do të ndërtohet një grup trajnuesish brenda institucionit.

Autoriteti i Konkurrencës i ka kushtuar dhe vazhdon t'i kushtojë vëmendje investimit në kapitalin human si faktor kryesor të rritjes së efijencës së ndërhyrjeve ndaj praktikave antikonkurrese. Për këtë arsye janë planifikuar një sërë trajnimesh me ekspertë të fushës brenda dhe jashtë vendit. Kështu, gjatë vitin 2009 do të zhvillohen trajnime të stafit në tre module mbi analizat ekonomike, statistikore dhe ekonometrike si dhe juridike nga profesorë të Fakulteteve të Ekonomisë dhe Juridikut të Universitetit të Tiranës, Shkollës së Magjistraturës, si dhe pranë Institutit të Trajnimit të Administratës Publike.

Në bashkëpunim të ngushtë me Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim në Europë (OECD) kemi planifikuar një sërë tranimesh në qendrën që mbulon edhe Shqipërinë në Budapest. Ekspertët e Autoritetit të Konkurrencës marrin pjesë aktive me prezantimin e rasteve dhe përfitojnë nga eksperiencia e vendeve të Europës Juglindore dhe ekspertëve të fushës OECD-së, BE-së, SHBA-së etj. Gjithashtu këtë vit qendra rajonale e OECD-së në Hungari ka zgjedhur Shqipërinë për të organizuar një seminar rajonal për të rritur kulturën e konkurrencës në vendet e rajonit dhe sidomos në përfitim të vendit organizator. Ky do të jetë një rast shumë i mirë për të gjithë ekspertët e Autoritetit të Konkurrencës për të zhvilluar aftësitë e tyre.

Me mbështetjen e GTZ-së, gjatë këtij viti do të organizohet një vizitë studimore pranë Bundeskartellamt-it ku do të marrin pjesë 4 ekspertë të Autoritetit të Konkurrencës për të përfituar nga eksperiencia më e mirë në fushën e kontrollit të përqëndrimeve, marrëveshjeve kartel, abuzimit me pozitën dominuese dhe menaxhimit të burimeve njerëzore.

Përfaqësuesit e Autoritetit të Konkurrencës do të marrin pjesë në seminarët që organizon Rrjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës (ICN), UNCTAD-i, Njësia e Trajnimeve të Komisionit Evropian (TAIEX) etj. Të gjitha informacionet dhe materialet e akumuluar nga këto pjesëmarrje do të ritrajtohen në ambjentet e institucionit për të mundësuar rishpërndarjen e njohurive.

IX.2. Monitorimi i tregut dhe hetimi i praktikave të mundshme antikonkurrese.

Gjatë vitit 2009 Autoriteti i Konkurrencës ka parashikuar një sërë hetimesh në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe në tregjet përkatëse ku ka sinjale për kufizime të mundshme të konkurrencës, do të vazhdojnë procedurat deri në vendimmarrje për hetimet e hapura. Në zbatim të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, ky institucion do të zhvillojë monitorime dhe hetime në tre kolona kryesore: abuzimi me pozitën dominuese, marrëveshjet e ndaluara dhe kontrolli i përqëndrimeve.

Autoriteti i Konkurrencës do të mbikëqyrë tregun për të monitoruar dhe hetuar sektorët e ekonomisë ku shfaqen shenja të kufizimit, shtrembërimit apo deformimit të konkurrencës në tregjet ku një/disa ndërmarrje kanë pozitë dominuese si : në tregun e hidrokarbureve; në sektorin e komunikimeve elektronike; në sektorin financiar; në sektorin e energjisë elektrike; etj.

Hetimi i sektorit anti-kartel do të fokusohet në evidentimin e praktikave të marrëveshjeve të ndaluara, kryesisht lidhur me hetimet që janë në proces si dhe në tregje të tjera të ndjeshme dhe të prirura ndaj fenomeneve antikonkurrese.

Gjithashtu gjatë vitit 2009 do të synohet aplikimi si një mënyre më efiçiente në përdorimin e programit të lehtësimit nga gjobat për të rritur interesin e biznesit dhe për ta ndërgjegjësuar atë që të bashkëpunojë me Autoritetin.

Vlerësimi i përqëndrimeve dhe ndryshimeve në strukturat e tregut pas përqëndrimit si rezultat i bashkimit, përfuturit të kontrollit apo krijimit të ndërmarrjeve të përbashkëta, do të kryhet kryesisht në tregjet ku këto transaksionet kanë ndodhur apo potencialisht mund të ndodhin si : ai i energjisë elektrike (pas privatizimit të OSSH-së); sektori i shërbimeve utilitare; sektori i aviacionit civil (bashkimi Austrian Airlines-Lufthansa); sektori financiar (pas privatizimit të INSIG); të tjera sipas rastit.

IX.3 Forcimi i kulturës dhe i advokacisë për Ligjin dhe Politikën Kombëtare të Konkurrencës.

Eksperienca e funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës ka treguar qartë se efiçienca e veprimtarisë së këtij institucioni varet në mënyrë të konsiderueshme nga perceptimi dhe reagimi i të gjithë aktorëve të tregut, pra nga kultura dhe advokacia për ligjin dhe politikën e konkurrencës. Gjatë tryezave të rrumbullakta

me komunitetin e biznesit u evidentua se një rol të rëndësishëm në zhvillimin e tregjeve lokale luajnë edhe pushteti vendor prandaj është planifikuar që me mbështetjen e GTZ-së të realizohen tryeza të rrumbullakta me Shoqatën e Bashkive në rrethe.

Në funksion të rritjes së advokacisë së ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, janë planifikuar disa ëorkshope dhe seminare trajnimesh me juristë të gjykatave dhe studiot ligjore pranë ambjenteve të Autoritetit të Konkurrencës dhe me ekspertë ndërkombëtarë të financuar nga TAIEX-i.

Gjithashtu, të gjitha paketat e legjislacionit primar dhe sekondar që janë në proces do t'i nënshtrohen një diskutimi dhe konsultimi me gjithë palët e interesit si institucionet publike dhe rregullatore, studiot ligjore dhe përfaqësuesit e sistemit të drejtësisë, komunitetin e biznesit dhe përfaqësuesit e qeverisë qendrore dhe vendore.

"Dita Shqiptare e Konkurrencës". Me rastin e 5 vjetorit të fillimit të punës së Autoritetit të Konkurrencës do të organizohet konferenca me temë "Konkurrenca në ekonomitë e vogla dhe informale". Autoriteti i Konkurrencës ka publikuar një thirrje për kontribute për të gjithë të interesuarit që të paraqesin prezantimet e tyre në këtë konferencë. Me pjesëmarrjen e ekspertëve të fushës nga autoritetet e rajonit të Europës Juglindore, Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës, akademikëve nga vendi dhe bota, synohet të diskutohet mbi veçoritë e zbatimit të Ligjit dhe Politikës së Konkurrencës në kushtet e ekonomive të vogla dhe me shkallë të konsiderueshme të informalitetit.

IX.4. Konsolidimi i bashkëpunimit institucional dhe marrëdhënieve ndërkombëtare të Autoritetit të Konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës edhe gjatë vitit 2009 do të angazhohet në respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga Plani Kombëtar i Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe do të synojë drejt përshpejtimit të procesit të integritit legjislativ. Sikurse është paraqitur në këtë raport, janë në proces disa paketa të rëndësishme të legjislacionit sekondar, të cilat synojnë plotësimin e kuadrit ligjor në fushën e konkurrencës, si dhe respektimin e angazhimeve të ndërmarra. Në këtë mënyrë janë parashikuar për t'u përshtatur disa udhëzues të Komunitetit European dhe praktikave më të mira kryesisht në fushën e marrëveshjeve të ndaluara dhe të përqëndrimeve.

Autoriteti i Konkurrencës do të vazhdojë bashkëpunimin me institucionet qendrore, entet rregullatorë, institucionet ndërkombëtare, etj duke synuar drejt një bashkëpunimi efektiv në mbrojtje të konkurrencës në treg. Nëpërmjet memorandumeve të mirëkuptimit të lidhur ndërmjet Autoritetit të Konkurrencës dhe këtyre organizmave kombëtarë dhe ndërkombëtarë është mundësuar marrja e informacioneve dhe shkëmbimi i eksperiencës, të cilat janë të nevojshme gjatë proceseve të ndryshme hetimore dhe studimore të ndërmarra nga AK.

Me qëllim ndërgjegjësimin e publikut për Ligjin dhe Politikën Kombëtare të Konkurrencës me mbështetjen e programit TAIEX të BE, janë aprovuar për tu organizuar 2 workshope në Tiranë. Gjithashtu gjatë vitit 2009 do të vazhdojë bashkëpunimi me ICN, OECD (RCC), me UNCTAD, GTZ, Autoritetet Homologe të Konkurrencës etj, bashkëpunime të cilat synojnë drejt një shkëmbimi eksperience dhe rritjes së nivelit të eksperiencës si dhe ekspertizës. Pjesëmarrja aktive e stafit në këto seminare, konferenca dhe ëorkshope ndihmon dhe do të ndihmojë në adoptimin e praktikave më të mira ndërkombëtare të konkurrencës në veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës.